



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom Dh.Shk.II.nr.1294/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, nga gjyqtari individual Krenar Berisha, në çështjen përmbarimore të kreditorit Sh.a KUR nga Mitrovica kundër debitorit H.B. nga Vushtria, me bazë juridike përmbarimore, për pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.510/20 të datës 11.11.2020, jashtë seancës me datë 24.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit H.B. nga Vushtria, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, CPP.nr.510/20 të datës 11.11.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Mitrovicë-Dega në Vushtri, me aktvendimin e atakuar, CPP.nr.510/20, të datës 11.11.2020, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit H.B. nga Vushtria, dhe ka vërtetuar urdhrin e përmbaruesit privat Atip Mustafa nga Vushtria, me numër P.nr.1414/2020, i datës 19.06.2020.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që pas shqyrtimit të tërë dokumentacionit të dosjes së lëndës, ta aprovoj ankesën, ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, apo lëndën ta kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk gjendet në shkresat e lëndës

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Sh.a KUR nga Mitrovica me datë 19.06.2020, ka paraqitur propozim për përmbareme ndaj debitorit H.B. nga Vushtria, në bazë të dokumentit të besueshëm-fatura Code, me të cilën ka kërkuar që në emër të borxhit për shfrytëzimin e ujësjellësit dhe shërbimeve të kanalizimit t,ia paguaj shumën prej 1,041.28€ me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita paraqitjes së propozimit e deri në pagesën definitivë te borxhit.

Përmbareuesi Privat Atip Mustafa nga Vushtria, duke vepruar sipas propozimit për përmbareme të kreditorit ka lejuar përmbaremin me urdhrin P.nr.1414/2020, të datës 19.06.2020, ndërsa kundër këtij urdhri debitorit ka ushtruar prapësim me datën 01.06.2021, duke theksuar se e kundërshton në tërësi borxhin e kreditorit me arsyetimin se dokumenti në bazë të cilit është iniciuar procedura përmbaremore nuk i përmbush kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, borxhi në fjalë është i pabazuar dhe ka propozuar që propozuar që të anulohet urdhëri për lejimin e përmbaremit.

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar CPP.nr.510/20 të datës 11.11.2020, ka vendosur që ta refuzoj prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivishtë si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar, për faktin se shuma e detyruar për debitorin duhet të paguhet nga debitorit dhe kjo gjen mbështetje në nenin 8 dhe 345 par.1 të LMD-së. Debitorit nuk arriti të argumentoi përmbushjen e borxhit ndaj kreditorit zvogëlimin e detyrimit apo shuarjen e tij.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marrë parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbarim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: faturat. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbarim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç është fatura për shfrytëzimin e ujësjellësit dhe shërbimeve të kanalizimit, për shumën e detyrimit prej 1,041.28 Euro, dhe se i njëjti është i përshtatshëm për përmbarim pasi që përmban të gjitha kërkesat nga neni 29 paragrafi 1 dhe nën paragrafi 2 të LPP-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të debitorit të paraqitura në ankesë lidhur me parashkrimin e borxhit, apo se ka bërë pagesën e borxhit në tërsi. Nga ekstraktet e faturave në librat e kontabilitetit debitori ka bërë pagesa të pjesërishme por jo në tërsi. Debitori në këtë lëndë juridike përmbarimore nuk ka ofruar prova që e ka përmbushur detyrimin e tij që rrjedh nga faturat, dhe se i njëjti as në prapësim e as në ankesë nuk ka bashkangjitur fakte që do të dëshmonin të kundërtën, andaj vlerësimin e Gjykatës së shkallës së parë, kjo Gjykatë e sheh si të drejtë dhe të ligjshëm. Nga të cekurat më lartë kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e debitorit si e pathemeltë.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1294/22 datë 24.08.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha